



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE

Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Blerje karburant për ngrohje dhe shpërdarje në objektet arsimore”

I mbajtur sot në datë 15.02.2024 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje karburant për ngrohje dhe shpërdarje në objektet arsimore”**, me fondin limit **51 53 574 816** (pesëdhjetë e tre milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) **Lekë pa Tvsh.**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me 1 (një) lloj malli (karburant për ngrohje) i destinuar për objekte të paracaktuara, pra nuk ka asnjë arsye apo shkak për ndarjen e procedurës në lote.

Së dyti, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin, ndër të tjera, sigurimin me ngrohje të objekteve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë. Shpërndarja e lëndës djegëse do të realizohet nga kontraktuesi nën monitorimin e autoritetit kontraktor direkt në objektet arsimore sipas planit të shpërndarjes të hartuar nga autoriteti kontraktor në çdo kontratë. Magazinat e autoritetit kontraktor ndodhen në zonën Vaqarr të Bashkisë Tiranë dhe përqendrimi i mallit në magazinë dhe më pas realizimi i shpërndarjes do të sillte kosto shtesë për autoritetin kontraktor.

Në këto kushte, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do ti duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe shpërndarjen e mallit nga

operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtin mall, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin dhe shpërndarjen e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.